



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2019:276963  
Datë: 26.01.2024  
Numri i dokumentit: 05247186

Ac.nr.10346/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryetare e kolegjit, Faton Ademi dhe Besnik Bislimaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësve A.A dhe XH.A nga fsh. ... Komuna Skenderaj, XH.J dhe J.J që të dy nga fshati Burojë, Komuna Skenderaj, këtë të fundit e përfaqëson e ëma XH.J, që të gjithë të përfaqësuar sipas autorizimit nga SH.I avokat në Skenderaj, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, që e përfaqëson me autorizim D.S zyrtare ligjore e të paditurës, në çështjen juridike për kompensim dëmi nga autopërgjegjësia, duke vendosur në lidhje me ankesën e paditësve të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.553/2019, i datës 02.12.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.01.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

APROVOHET e themeltë ankesa e paditësve A.A dhe XH.A nga fsh. ... Komuna Skenderaj, XH.J dhe J.J që të dy nga fshati Burojë, Komuna Skenderaj, këtë të fundit e përfaqëson e ëma XH.J, PRISHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.553/2019, i datës 02.12.2020 dhe qështja i kthehet të njëjtës në rigjykim dhe rivendosje.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.553/2019, të datës 02.12.2020 ka vendosur si në vijim:

*“Refuzohet ne tërësi si e pa bazuar kërkesë padia e paditësve A.A dhe XH.A nga fshati ... dhe XH.J dhe J.J nga fshati Burojë, komuna Skenderaj, në çështjen juridike për kompensim të demit nga autopërgjegjsia për arsye se padia është ushtruar pas kalimit të afatit të përcaktuar ligjor.*

*Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.”*

Kundër këtij aktgjykimi ankesë në afat ligjor ka paraqitur i autorizuari i paditësve, për shkak të shkëljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar ndërsa aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë ta ndryshoj ashtu që të prishë aktgjykimin dhe çështjen t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar e paditura.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditësve është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, përmes të autorizuarit të tyre me datë 12.07.2012, në gjykatën e shkallës së parë, kanë paraqitur padi, me të cilën ka kërkuar kompensimin e demit material dhe jo material, në padi paditësit kanë theksuar se, me datë 15.08.2007, ka ndodhur aksident i komunikacionit, ku si pasojë e këtij aksidenti paditësit kanë pësuar lëndime trupore për qka kanë kërkuar kompensimin e demit material dhe jo material me arsye si në padi.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.365/2012 të datës 30.10.2015, e kishte aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të atij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit të Kosovës me aktvendimin Ac.nr.4870/15 të datës 14.10.2019, e kishte aprovuar si të bazuar ankesën e të paditurës dhe ka prishur aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Skenderaj C.nr.0365/2013 të datës 30.01.2015 dhe lëndën e i kthehet në rigjykim dhe vendosje

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, në rigjykim dhe rivendosje, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.553/2019, të datës 02.12.2020, me të cilin e ka refuzuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se, nga provat e administruara, ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësve nuk është e themeltë, pasi që sipas referatit të padisë deklarimeve të përfaqësuesit të paditësve dhe Kallëzimit Penal të Njësisë se Trafikut Regjional ne Mitrovicë nr. 2007-BR-521 të dt. 15.08.2007 vërtetohet se me dt. 15.08.2007 rreth orës 15:45 ne rrugën lokale që shkon ne drejtim të fshatit L., ne fshatin Marinë afër shtëpisë se V.G është shkaktuar aksident trafiku me fajin e ngasësit të veturës N.N me targa

te regjistrimit N.N, ngjyrë të kuqe dhe si pasoj e këtij aksidenti kanë pësuar lëndime trupore 3 persona dhe dëme materiale.

Gjykata e shkallës së parë me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, me parashtrësë të dt. 14.09.2020 ka kërkuar nga Njësiti i Trafikut Regjional në Mitrovicë sqarime se a janë zhvilluar hetime ne drejtim të identifikimit të personit N.N qe e ka qenë pjesëmarrës në aksident të trafikut por nuk kemi marrë përgjigje dhe as paditësit nuk kanë arritur që të sigurojnë prova se është bërë identifikimi i shkaktarit të aksidentit.

Me tutje ka theksuar se, gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar pretendimet e palës se paditur lidhur me parashkrimin e kërkesëpadisë dhe për këtë i ka analizuar provat në shkresat e lëndës dhe ka konstatuar se nga momenti i hartimit të Raportit të aksidentit me dt.15.08.2007 dhe i ushtrimit te Kallëzimit penal, paditësit kanë marrë në dijeni për dëmin e pësuar dhe për shkaktarin e tij e qe ne rastin konkretisht është personi i pa identifikuar N.N dhe automjet N.N dhe prej këtij momenti ka filluar të rrjedhë afati i parashkrimit tre (3) vjeçar i kërkesës për shpërblim të demit ku në dispozitat e nenit 367 par.1 të LMD, GZ nr. 29/78 shprehimisht është përcaktuar “Kërkesë shpërblimi të demit të shkaktuar parashkruhet për 3 vite nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin”. Në rastin konkret nga data e Raportit të aksidentit, ushtrimit të Kallëzimit penal paditësit janë njoftuar për dëmin dhe për subjektin që është i obliguar për shpërblim të demin për personat dhe automjetin e pa identifikuar. Paditësit padinë e kanë ushtruar me dt. 12.07.2012 ndërsa për dëmin janë njoftuar me dt.15.08.2007 nga rezulton se padia për shpërblim të demit është ushtruar pas katër (4) vite pas shkaktimit të aksidentit. Në rastin konkret kërkesa e paditësve është parashkruar sipas dispozitave te nenit 376 par1 të LMD-së nga u cek me lart se kërkesa për shpërblim të demit parashkruhet në afat prej 3 viteve nga data kur i dëmtuari ka marrë për dijeni për dëmin dhe personin i cili e ka shkaktuar dëmin, ne këtë rast kemi të bëjmë me afat subjektiv që për zbatimin e afatit subjektiv të parashkrimit duhet të plotësohen dy kushte subjektive, se dëmi është shkaktuar dhe paditësi ka ditur për dëmin e shkaktuar dhe për personin që e ka shkaktuar dëmin. Gjykata vlerëson se paditësit kanë ditur për dëmin e shkaktuar për personin dhe automjeti N.N, nga momenti kur kanë marrë raportin e aksidentit nga Policia e Njësitet të Trafikut Regjional në Mitrovicë. Pretendimet e paditësve se padia është e afatshme sepse është brenda afatit prej pesë (5) vite duke u arsyetuar me shkaqet e mos zbulimit të shkaktarit të demit, janë pretendime të pa bazuara sepse nuk ka pasur pengesa ligjore për paditësit të ushtrojnë padi në afatin ligjor për shpërblim të demit nga autopërgjegjësia për rastet kur personi dhe automjeti shkaktar i aksidentit është N.N bazuar në dispozitat e nenit 20 paragrafi 1 të LSDA nr.04/L-018 ku është përcaktuar” Personi fizik i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi nga përdorim imi i mjetit motorik të paidentifikuar, ka të drejtë të parashtrroj kërkesën për shpërblim Byros”.

Në rastin konkret gjykata është bazuar në faktet e vërtetuara nga provat në shkresat e lëndës duke konstatuar se kundërshtimet e të paditurës kane mbështetje në dispozitat ligjore materiale të cituara më lartë si dhe praktikat gjyqësore (Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.383/2019 i dt. 14.01.2020).

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 lidhur me nenin 160 paragrafi 4 të LPK-së, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe si rrjedhojë e kësaj zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata e Apelit pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të paditësve erdhi në përfundim se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182.2 pika (n) lidhur me nenin 160.4 të LPK-së, kjo gjykatë vlerëson se, edhe pse pala paditëse është thirrur në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nuk e ka cekur konkretisht në cilën dispozitë, mirëpo nga përmbajtja e ankesës shihet se ka pretenduar se, dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin, prandaj qëndron ky pretendim, dhe atë për faktin se dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me vetveten dhe me arsyet e tij kështu duke mos qenë në harmoni logjike dispozitivi me arsyetimin. Në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar është vendosur që të refuzohet kërkesa e paditësve për kompensimin e dëmit, për shkak të parashkrimit të kërkesës mirëpo pa specifikuar se cila ka qenë kërkesa e palës paditëse, gjykatës së shkallës së parë i ka mjaftuar që të vendos refuzohet kërkesëpadia e paditësve për kompensimin e dëmit nga autopërgjegjësia pa specifikuar për llojet dhe lartësinë e dëmit, pra nuk vendosur sipas parashtresës për precizim të kërkesëpadisë të datës 26.12.2014 për të gjitha format e dëmit material dhe jo material, respektivisht për shumën që është kërkuar pala paditëse.

Po ashtu, aktgjykimi i atakuar është marrë në kundërshtim edhe me nenin 160.4 të LPK-së dhe atë për arsye se gjykata në arsyetim të aktgjykimit të saj ka përshkruar thëniet e palëve, po ashtu vetëm ka përshkruar provat të cilat i ka marrë për bazë me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, mirëpo këto prova nuk janë të arsyetuara më konkretisht nuk mund të kuptohet se çka ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë me anë të provave dhe si i ka vlerësuar të njëjtat, ashtu që nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se realisht çka ka qenë kontestuese për gjykatën e shkallës së parë e çka jo.

Gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë dhe si pasojë e kësaj ka ardhur deri të zbatimi i gabuar i të drejtës materiale, për arsye se nuk ka qenë kontestuese se me datë 15.08.2007 ka ndodhur aksident trafiku në rrugën lokale L. - M. në fshatin Marinë me ç' rast paditësit kanë pësuar dëme jo material dhe material. Sipas Raporti të aksidentit nr.2007-BR-521 i përpiluar me dt. 15.08.2018 dhe Kallëzimit penal i Njësitit të Trafikut Regjional në Mitrovicë, aksidenti është shkaktuar nga NN personi dhe NN automjeti. Nga këto prova shihet se aksidenti ka ndodhur me datë 15.08.2007, ndërsa paditësit padinë e kanë ushtruar me dt. 12.07.2012 që do të thotë pas katër (4) vite pas shkaktimit të aksidentit. Mirëpo në aktgjykimin e atakuar nuk janë dhënë arsye se cili prej pjesëmarrësve në aksident ka dhënë kontribut në shkaktimin e aksidentit, respektivisht kush nga pjesëmarrësit ka qenë shkaktar i aksidentit, edhe pse në shkresat e lëndës gjendet ekspertiza nga lëmia e komunikacionit e datës 29.10.2020, nga eksperti Sejdi Berisha. Si pasojë e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ka ardhur edhe deri të zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.

Me dispozitën e nenit 376 i LMD paragrafi 1 dhe 2 ( i vitit 1978) përcaktojnë se: *“Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin. Sidoçoftë kjo kërkesë parashkruhet për pesë vjet nga data kur është krijuar dëmi.”* Është fakt se deri në momentin e paraqitjes së padisë kanë kaluar me tepër se 3 vite nga shkaktimi i dëmit, por paditësit në rastin konkret i referohet afatit objektiv, që nënkupton afatin e përgjithshëm brenda të cilit duhet patjetër që të paraqitet padia, përndryshe me kalimin e këtij afati humbet edhe e drejta për kërkimin e kompensimit. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye lidhur me pretendimet e palës paditëse se i përketë afatit objektiv i paraparë me nenin 376 paragrafi 2 i LMD-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, nuk është e qartë nëse për aksidentin e ndodhur është shpallur fajtor shkaktari i aksidentit, meqenëse në shkresat e lëndës gjendët Kallëzimi Penal i Njesisë se Trafikut Regjional ne Mitrovicë nr. 2007-BR-521 të dt. 15.08.2007, dhe nëse lidhur me këtë ka vendim penal, pra nëse është zhvilluar procedura penale dhe cili është vendimi lidhur atë çështje. Pra në rastin konkret ka mbetur pa u sqaruar nëse aksidenti ka ndodhur si pasojë e veprës penale të kryer nga personi i cili ka qenë shkaktar i aksidentit të ndodhur dhe pasojave që ka lënë tek paditësit, e kjo krejt me qëllim të vlerësimit me të drejtë të parashkrimit të kërkesës apo jo.

Andaj, bazuar në të lartcekurat Gjykata e Apelit ka vendosur që çështjen të kthejë në rigjykim dhe rivendosje, në atë mënyrë që, në ri procedurë gjykata e shkallës së parë duhet të eliminojë vërejtjet dhe shkeljet e konstatuara, nga kjo gjykatë, ashtu që fillimisht të eliminojë shkeljet e dispozitave të procedurës, të vendos në plotni për kërkesën e palës paditëse, të veproj sipas udhëzimeve të dhëna nga Gjykata e Apelit më aktvendimin Ac.nr.4870/15 të datës 14.10.2019, konform nenit 199 të LPK-së, ashtu që të kërkoj nga organet e ndjekjes (Policia dhe Prokuroria, respektivisht Njesisë së Trafikut Regjional Mitrovicë dhe Prokurorisë Themelore në Mitrovicë) ose edhe nga vetë paditësit, se a është identifikuar personi NN, i cili ka qenë i përfshirë në aksidentin e datës 15.08.2012, më pas të vlerësojë edhe njëherë të gjitha provat një nga një dhe të gjitha së bashku, ashtu që arsyetohet saktë se çka ka vërtetuar nga to, pra të vërtetojë siç duhet gjendjen faktike e sidomos të zbatohet të drejtën materiale konkrete, e po ashtu me rastin e hartimit të vendimit të bazohet në elementet e specifikuara në nenin 160 paragrafi 4 i LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika c) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.10346/2021, me datë 16.01.2024

Kryetare e kolegjit  
Hidajete Gashi Alaj, d.v.